

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"GOLDEN WALLET PROPERTIES" SHPK

Sot, më datë 03/02/2025, u paraqit personalisht:

- Zj. Meri Mema, e datëlindjes 11/12/2004, shtetase shqiptare, lindur në Fierdhe banuese në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtse e kartës se identitetit me Nr. 037235821 dhe Nr. Personal K46211035K.**

I cili përpiloj këte akt themelimi të shoqërisë tregtare "GOLDEN WALLET PROPERTIES" SH.P.K, me termat e mëposhtme:

NENI 1
Forma Ligjore

Të themeloj Shoqërinë Tregtare "GOLDEN WALLET PROPERTIES" SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "GOLDEN WALLET PROPERTIES" SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3
Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit "GOLDEN WALLET PROPERTIES" SH.P.K dhe me emrin tregtar **GOLDEN WALLET PROPERTIES**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4
Objekti i veprimitarise

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

1. Agjenci imobiliare dhe marketimi . Krijim, zhvillim, zyra ndërmjetësimi per pasurite e paluajtshme nepermjet nënshkrimit të nje kontrate te veçante Franchising, aktivitet ndërmjetësimi per pasuritë e paluajtshme. 2. Aktivitet ne fushën e pasurive të patundshme, vlerësimin e pasurive te patundshme, te angazhohet ne shitjen me shumicë dhe pakice të çdo lloj pasurie dhe te hap dyqane, dege apo zyra po te jete e nevojshme per arritjen e qellimit te shoqerise. Menaxhim dhe administrim pronash dhe objektesh. Administrimin e bashkeproneseje në prona dhe ndertesa. Per dhenien me qira, nen qira te ambienteve te ndryshme. 3. Aktivitet ne fushen e projektimit te

godinave civile, mirembajtje dhe restaurim të objekteve te ndryshem. 4. Organizimi i eveneve, panaireve, publikime, reklama dhe fushata reklamuese, si dhe organizim tjeter artistik dhe televiziv te çdo forme. Konsulencë financiare, ekonomike, juridike që ka lidhje me biznesin, me aktivitetet te ndryshme tregtare te personave fizik dhe juridik perfshire institucionale financiare dhe ato shtetërore. 6. Ndërmjetësim ne lidhje me shitje të produkteve të ndryshme. 7. Investime ne fushën e ndërtimit dhe tregtimit brenda dhe jashtë vendit te pasurive te pa luajtshme. 8. Transportim mallrash, shërbime te ndryshme te lidhura me këtë aktivitet.

9. Sherbime mbi krijimin, planifikimin dhe zbatimin e fushatave te komunikimit Si dhe forma te tjera promocionale dhe reklamuese. Fushata marketingu online. Pergatitje e komunikimeve online dhe blerje hapesirash dixhitale. Sherbime kreative per te gjitha permasat dhe format e njohura elektronikisht dhe vizualisht. Sherbime fotografie. Mirembajtjen e faqeve te internetit dhe faqeve te mediave sociale.

Shoqeria, me vendim te Administratorit, mund te lidhe marreveshje tregtare apo bashkepunimi me shoqeri apo sipermarrje te tjera, si dhe te kryeje cdo veprim tregtar qe konsiderohet i nevojshem me qellim arritjen e objektit te veprimtarise se saj.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Rr."Dëshmorët e 4 Shkurtit", Alban Tower, Kati 6.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është Lekë 100.000 (njeqind mijë leke) dhe zotërohet nga ortaket themelues:

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: Lekë 100.000 (njeqind mijë leke)

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku themelues.

NENI 7

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare "GOLDEN WALLET PROPERTIES" SH.P.K zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortaku themelues : **Meri Mema**

Numri i kuotave : **1**

Numri i pjesave : **1**

Pjesemarrja ne Shoqeri : **100,00 %**

Lloji i kontributit: **Ne para**

Vlera e kontributit **100,000 (njeqind mijë) leke**

Duke qene se Kapitali themeltar do te depozitohet ne llogarine e Shoqerise e cila do te hapet pas regjistrimit ne QKB, atehere ortaku vendos qe kjo shume do te paguhet prej tij jo me vone 3 muaj nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB, ne llogarine e shoqerise tregtare.
Rregullat e pageses se kesaj shume jane parashikuar ne kete Statut.

NENI 8 Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9 Administratori/ët

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqerise do te jetë :

- **Zj. Meri Mema, e datëlindjes 11/12/2004, shtetase shqiptare, lindur në Fierdhe banuese në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtese e kartës se identitetit me Nr. 037235821 dhe Nr. Personal K46211035K.**

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjeter privat, me përashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 12

Mosmarrveshjet për themelin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Faqe 3 nga 4

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues, u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaku eshte njohes i gjuhes shqipe.

ORTAKU THEMELUES

MERI MEMA

Meri Mema
[Signature]